

Help


Hilfe zur Selbsthilfe

help-kosovo.org



TË DHËNAT &
REZULTATET

STORJE
SUKSESI



RRETH NESH

Organizata Help filloi misionin në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2000, kur Kosova ishte ende në fazën emergjente. Pas disa viteve pauzë në maj të vitit 2015 Help filloi me projektin "Mbështetje për stabilitetin social-ekonomik nëpërmjet fuqizimit të sektorit të mikro-bizneseve në Kosovë".

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontriboj në zhvillim dhe stabilitet të qëndrueshëm në zonat e synuara ku fokusi kryesor është fuqizimi ekonomik. Një ndër qëllimet specifike të Help është: krijimi i vendeve të punës përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë ekonomike dhe edukative në sektorin e mikro-biznesit në Kosovë.

Projekti financohet nga Zyra Gjermane për Punë të Jashtme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Qeverisë së Kosovës, dhe nga komunat partnere. Ky projekt implementohet nga Help – Hilfe zur Selbsthilfe e.V. Kosovo.

PROJEKTET E PËRFUNDUARA

Maj 2015 – Dhjetor 2015

Projekti "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik nëpërmjet fuqizimit të sektorit të mikro-biznesit në Kosovë"

Donatorë: Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë Gjermane, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komunat partnere

Lokacioni: Republika e Kosovës

Komunat: Prishtina, Mitrovica, Ferizaj, Graçanica, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Vushtrri, Gjakovë dhe Gjilan.


Janar 2016 – Dhjetor 2017

Projekti: "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik nëpërmjet fuqizimit të sektorit të mikro-biznesit në Kosovë - Parandalimi dhe Stabilizimi i Migracionit"

Donatorë: Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë Gjermane, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komunat partnere

Lokacioni: Republika e Kosovës

Komunat: Prishtinës, Graçanices, Gjakove, Vushtrri, Gjilan, Mitrovica, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Vushtrri, Peje, Prizren and Novobërd



PROJEKTI AKTUAL

Maj 2017 – Dhjetor 2018

Projekti: "Mbështetje për stabilitetin socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor 2017-2018"

Donatorë: Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë Gjermane, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komunitat partnerë
Lokacioni: Republika e Kosovës

Komunitat: Suhareka, Lipjan, Deçan, Shterpcë, Istog, Gjakovë, Graçanica, Mitrovica dhe Mitrovica e Veriut.

Objektivi i përgjithshëm i programit është rritja e kapaciteteve të grupeve të cënueshme ekonomisht dhe shoqërore për të marrë pjesë më plotësisht në shoqëri.

Objektivi specifik i programit: Zvogëlimi i niveleve të varfërisë në mesin e grupeve ekonomisht të cënueshme

Komponentet e projektit që do të ndikojnë në krijimin e drejtpërdrejtë të vendeve të punës për të paktën 240 punonjës të regjistruar, duke kontribuar kështu në stabilitetin socio-ekonomik në zonat e synuara janë:

- Grante për mikro-biznese
- Trajnime profesionale & biznesore
- Perkrashje të nismave sipërmarrëse dhe iniciativave në gjithë vendin.

PARTNERËT TANË

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Komunitat e Prishtinës
- Komunitat e Prizrenit
- Komunitat e Pejës
- Komunitat e Gjakovës
- Komunitat e Mitrovicës
- Komunitat e Ferizajit
- Komunitat e Gjilanit
- Komunitat e Vushtrris
- Komunitat e Suharekës
- Komunitat e Istogut
- Komunitat e Deçanit
- Komunitat e Lipjanit
- Komunitat e Leposaviqit
- Komunitat e Novobërdës
- Komunitat e Graçanicës
- Komunitat e Shterpcës
- Komunitat e Mitrovicës së Veriut



TË DHËNAT & REZULTATET

17 KOMUNA TË MBËSHTETURA
QE NGA MAJI 2015

850 GRANTE TË
PËRFUNDUARA, NË
VAZHDIM TE ARRITJES
1,000
GRANTE


STATISTIKAT NGA MAJ-2015




MBI

5,000


APLIKACIONE
NGA VITI 2015




NDARJA E GRANTEVE SIPAS
SEKTOREVE



ZONAT GJEOGRAFIKE



PËRKATËSIA ETNIKE



NIVELI ARSIMOR



67%



33%

KLIENTËT SIPAS GJINISË



698

AKTIVITETE TE
REGJISTRUARA, QË ËSHTË
82% NGA TË GJITHA
GRANTET

300

START-UP U KRIJUAN ME
MBËSHTETJEN E **Help** QË
ËSHTË **33%** E
GRANTEVE TË DHËNA



MBI

600

TRAJNIME TË
PËRFUNDUARA
(PROFESIONALE
& BIZNESORE)

MBI

350
TE PUNËSUAR
80%

E TYRE JANË ZYRTARISHT TE
REGJISTRUAR



TË ARDHURAT MESATARE MUJORE

405€

MBI

500

PERSONA KANË PËRFITUAR NGA
INICIATIVAT ME BAZË NE KOMUNITET
TE MBËSHTETURA NGA **Help**
NË SEKTORË TË NDRYSHËM TË
EKONOMISË NË KOSOVË



INICIATIVAT ME BAZË NË KOMUNITET (CEI)

- "Aureola" Prishtina - Zejtari
- "SHE-ERA" Gjakova - Zejtari
- "Gratë Femere, Krusha e Vogël" Prizren - Bujqësi
- "Kroi i Sfeçlës" Podujeve - Bujqësi
- "Gratë e Bashkuara, Komogllavë" Ferizaj - Zejtari
- "Down Syndrome Kosova" Prishtina & Prizren - Shërbime
- Shoqata "Hadër" Prizren - Zejtari
- "CBC Innovation Hub" Istog - Shërbime
- "Jakova Innovation Center" Gjakova - Shërbime
- "FLOSSK" Prishtina - Shërbime
- "MakerSpace" Prizren - Shërbime
- "Qendra për Këshillim në Karrierë" Prishtina - Shërbime
- "Center for Education & Development X" cedX Peja - Shërbime
- "Qendra e Aftësimit Profesional" Zveçan - Shërbime
- "Qendra edukative-korrektuese" Lipjan - Shërbime
- "Shoqata e të shurdhërve" Suhareka - Shërbime

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Takimet me komunat organizohen në fillim të zbatimit të projektit për të konfirmuar aktivitetet e planifikuara siç është rënë dakord gjatë fazës së përgatitjes së projektit.

Në përputhje me përvojat e mëparshme, secila komunë emëron nga një përfaqësues për të ndjekur dhe për të bashkëpunuar me ekipin e projektit të Help gjatë zbatimit të projektit.

Në përputhje me aktivitetet e planifikuara, Marrëveshjet e Bashkëpunimit përgatiten dhe u dërgohen partnerëve lokalë për miratim dhe nënshkrim zyrtar.



SEANCAT INFORMUESE

Fushatat e informimit organizohen dhe zbatohen në bashkëpunim me partnerët e projektit si dhe me palët e interesit, dhe përfaqësuesit e mediave.

Një numër i takimeve të hapura informative organizohen për individët e interesuar.

Qëllimi i takimeve është informimi i aplikantëve potencialë në lidhje me mundësitë e projektit si dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik për projektin dhe për të paraqitur kriteret e përzgjedhjes.

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES ME KLIENTË

Klientët e përzgjedhur, do të marrin ndihmë financiare në formën e pajisjeve në vlerë mesatare prej 2,000 EURO dhe trajnimin e duhur profesional. Kontratat e grantit nënshkruhen ndërmjet Help dhe klientëve të përzgjedhur, duke specifikuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë kontraktuese dhe kushtet nën të cilat përfundimisht do të bëhet transferimi i pronësisë.

Obligimet kryesore janë: të paguaj kontributin 15%; të regjistrojë veprimtarinë afariste në përputhje me legjislacionin e Kosovës para marrjes së pajisjeve, ose në rast se biznesi është i regjistruar të punësojë te pakten 1 punëtor/e të funksionalizojë biznesin brenda 3 muajve dhe të marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga ekipi Help. Nëse klienti i nuk i përmbush detyrimet e mësipërme atëherë kjo do të na dërgojë deri në anulimin e kontratës dhe tërheqjen e pajisjeve të dhuruara.



BLERJA DHE SHPËRNDARJA E PAJISJEVE

Blerja dhe shpërndarja e pajisjeve fillon pasi kontratat e grantit me klientët e përzgjedhur janë nënshkruar. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit përfshin specifikimin e pajisjeve dhe grupimin e artikujve për blerje. Shpërndarja e pajisjeve do të bëhet sipas procedurave të Help të shoqëruara me dokumente të përshtatshme dhe në kohën e duhur.

Pajisjet për klientët blihen nga kompanitë vendore, kjo kontribuon në mbështetjen e mëtejshme të ekonomive lokale në zonat e synuara. Shpërndarja e pajisjeve për klientët e Help ndiqet nga punonjësit e Help.



TRAJNIME PROFESIONALE & BIZNESORE

Çdo klient përfiton trajnime rreth aftësisimit profesional i ofruar nga Help përmes ofruesve të shërbimit lokal të akredituar.

Mbështetja u ofrohet të gjithë klientëve tanë për të zhvilluar kapacitetin dhe për të rritur efikasitetin, duke krijuar kështu mundësinë për performancë konkurruese dhe profitabilitet afatgjatë si një ndër qëllimet kryesore.

Trajnimi mbështet sipërmarrësit në kapërcimin e pengesave dhe vështirësive që hasen në aktivitetet e tyre të përditshme duke i japur atyre nxitje dhe motivim shtesë.

MONITORIMI DHE KËSHILLIMI PËR BIZNESET

Karakteristikat kryesore që duhet të monitorohen janë: zbatimin e trajnimit, shpërndarjen e inputeve materiale, fillimin dhe përparimin e procedurës së regjistrimit, të start-up dhe zhvillimin e bizneseve individuale.

Detyra më e rëndësishme e Zyrtarëve të Help është ndjekja dhe sigurimi i ndihmës shtesë për mikro-bizneset.

Zyrtarët e Help do të angazhohen në mirëmbajtjen dhe përditesimin e dosjeve të klientëve me informacione të nevojshme për vlerësimin e zhvillimit drejt arritjes së objektivave të caktuara.







URIM VITAKU

Është dentist i ri nga Prishtina. Ai ka diplomuar për stomatologji në Universitetin EGE në Izmir. Pas katër viteve Urimi vendosi të hapë ordinancën e tij. Help e mbështeti atë me një karrige dentare, në mënyrë që të kompletojë ordinancën e tij. Përveç vetes, ai ka arritur të punësojë edhe dy persona të tjerë.



JELENA MARINKOVIĆ

Jelena Marinković është një fermere e suksesshme nga Graçanica. Nga Help Jelena ka përfituar pajisje për bluarjen e ushqimit për kafshë, siç janë derrat dhe pulat. "Këto pajisje e kanë lehtësuar punën time në këtë aktivitet duke i zvogëluar shpenzimet dhe duke rritur efikasitetin e punës".

ARTA SHEHU-ZAIMI

Arta Shehu-Zaimi është themeluese e Akademisë JCoders. Kjo akademi ka si fokus edukimin, duke ofruar një program unik trajnimi për gjeneratën e ardhshme të zhvilluesve.

Pas trajnimit, studentët do të transformohen nga përdorues të teknologjisë në krijues të teknologjisë.

Duke mënjanuar sintaksen, JCoders janë të fokusuar vetëm në logjikën e programimit. Arta nga Help ka përfituar 10 laptopë për të filluar biznesin e saj.



DENIZ TORTOSHI

Deniz Tortoshi është klient nga Prishtina, themelues i kompanisë Rolling Rabbits. Ai është drejtor ekzekutiv i një firme për dizajnim me përvojë shumëvjeçare në industrinë e projektimit. Help ka mbështetur Denizin me pajisje teknologjike për kompaninë gjë që ka ndikuar në zhvillimin e kapacitetit të kompanisë.



HANA QERIMI

Hana së bashku me Darsej Rizaj themeluan shkollën e quajtur "Shkolla Digjitalë" ku objektivi kryesor i saj është edukimi i të rinjve nga mosha 7-18 në shkencat kompjuterike dhe programim.

Biznesi filloi me vetëm 1.000 euro, i cili është një motivim për të tjerët që duan të krijojnë një biznes fillestar. Organizata Help i ka mbështetur ata në fillim të projektit.


Sot shkolla numëron rreth 600 studentë dhe më shumë se 20 punonjës në Prishtinë dhe Ferizaj ku është e vendosur kjo shkollë.

05

LORETA UKSHINI

Loreta është kliente nga Prishtina e cila zotëron një biznes të vogël të quajtur I'M LU (e cila qëndron për emrat e çiftit).

Ata prodhojnë çanta, kuleta dhe mbulesa për jastëk me dizajne të veçanta për të gjitha moshat. I'M LU kanë përfituar nga Help makina qepëse të sofistikua.



07

SAŠA ZIVIĆ

Saša Zivic ka marrë përpunues ushqimor për kafshët në mënyrë që të mund të prodhojë ushqim për kafshët e tij në fermë.

Help e ndihmoi Saša të zgjeronte fermën e tij, si dhe të rritë kapacitetin dhe kualitetin e saj. Falë donacionit tani familja e tij gjeneron te mira materiale çdo muaj.



LINDITA KRASNIQI

Është një sipërmarrëse e re nga Prishtina e cila ka marrë grant në vitin 2015. Ajo ka marrë makina qepëse me funksione të ndryshme, me qëllim që të hapë aktivitetin e saj të pavarur.

Ajo bën prodhimin e kompleteve të krevatëve (me dimensione të ndryshme), jastëkëve dhe mbulesave, peceta dhe peshqir për restorantet dhe kafene.

Përveç vetës që është regjistruar zyrtarisht si e punësuar, ajo gjithashtu ka punësuar edhe një person tjetër në kompaninë e saj.

08

MEBUSANE PACAK

09

Ajo është kliente nga Prizreni e cila punon në aktivitete printimi për klientë të rregullt dhe gjithashtu për kompani të ndryshme. Help e mbështeti atë me pajisje printimi dhe pajisje të tjera teknologjike për zyre, kryesisht karta biznesi, fletëpalosje etj. Prodhimet e saj mund edhe të plastikohen me pajisje të sofistikuar të marra nga Help.



11

FISNIK BEKOLLI

Fisnik Bekolli ka eksperiencë në fushën e gastronomisë për rreth 22 vite, tani ai drejton një biznes të vogël të quajtur "Bar Academy", me mbështetjen e "Help Kosovo" ai është furnizuar me pajisje të ndryshme për gastronomi gjë që ka ngritur kapacitetin e kompanisë dhe ka mundësuar ofrimin e trajnimeve.



VULLNET SANAJA

Vullnet Sanaja së bashku me Petrit Gora dhe Blend Beqiri nga Peja janë organizatorë të Festivalit të animuar "Anibar" në Komunën e Pejes. Ata kanë marrë pajisje të teknologjisë nga Help. Ata gjithashtu organizojnë kurse të animacionit për të rinjtë e Pejës me profesora të cilët vijnë nga Kosova apo nga vende të tjera.

Idea e tyre është të krijojnë një brez të animatorëve dhe dizajnerve. Festivali ndodh gjatë sezonës të verës ku aty shfaqen dokumentarë të shkurtë si dhe angazhohen vullnetarë të rinj nga çdo qytet i Kosovës.

NJOMZA HAVOLLI-SELISHTA

Njomza Havolli-Selishtë është një arkitekte e re nga Prishtina. Ajo ka filluar biznesin e saj të quajtur MUZA SHPK, me kolegen e saj Fitore Sylja.

Ato kanë përfutur pajisje profesionale nga Help dhe tani zyra e saj ka dy punonjës si dhe janë ngritur kapacitetet e kompanisë.



DONIKA MAKOLLI

Donika është një dizajnere e re në fushën e grafikes nga Graçanica. Ajo ka diplomuar në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës.

Ajo ka marrë një IMAC dhe një printer profesional nga Help, që e ndihmoi atë të krijonte biznesin e saj.



YLBER BRECA

Ylberi është pronar i kompanisë "Breca" në Prishtinë, i cili ofron shërbime për mirëmbajtjen e automjeteve. Help ka përkrahur Ylberin me pajisje për ngritje profesionale të automjeteve. ai ka rritur kapacitetin e kompanisë dhe ka përmisuar shërbimet. Ai gjithashtu ka punësuar 2 persona.



ILIRE LEPAJA

E diplomuar në Universitetin e Prishtinës me Master në dizajn grafik, Lepaja punoi si projektuese e pavarur për dhjetë vite deri sa ajo vendosi të hapte biznesin e saj. U deshën tre vjet për të krijuar dyqanin që tani është vetëm disa minuta larg nga ndërtesa kryesore e qeverisë së Kosovës.

Ndryshe nga dyqanet e tjera të suvenireve, Art e Zanat, në pronësi të Ilire Lepaja, sjell një alternativë për klientët e saj: një sërë suvenirësh të frymëzuar nga motive shqiptare që simbolizojnë një pjesë të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Organizata Help mbështeti atë me pajisjet e nevojshme për biznesin e saj dhe definitivisht Ilire Lepaja është një nga klientet më të suksesshëm të Help.




MILICA DIMITRIJEVIĆ

Milica Dimitrijevic dhe bashkëshorti i saj Aleksandar Kapetanovic janë pronar të auto larjes "TUS" në Graçanicë. Help e mbështeti biznesin e tyre të vogël me pajisje për larje të veturave. Ata gjithashtu kanë punësuar një puntor.



FORMON

Formon është kompani që prodhon printerë 3D të prodhuar në Kosovë. Help mbështeti Formon në fillim të aktivitetit të tyre. Këta të rinj janë fitues të çmimit të artë në "A'Design Award & Competition" në vitin 2017. Shkurt thënë këta janë një grup të rinjsh projektet e të cilëve duhet ti përcillni.




MILENKA PREMOVIĆ

Milenka është unike jo vetëm për komunën e Leposaviqit, por për të gjithë Kosovën pasi ajo është femra e vetme në vend që riparon motorët e makinerisë së rëndë, një aktivitet që e ka ndihmuar atë të mbështesë familjen e saj për shumë vite.

Në vitet e fundit, djali i saj i është bashkuar biznesit. Shumica e klientëve të saj janë furnizues të industrisë minerare Trepça dhe donacioni i Help ka mundësuar rritjen e fluksit të punës si dhe rritjen e cilësisë dhe efikasitetit.

FATOS GUBETINI

Fatos Gubetini punon dekorime nga druri si ora, logo të ndryshme, dhe dekorime me kërkesa të veçanta nga klientët. Ai është pronar i nje lokali dekorimesh i cili gjendet në Grand Store. Ai është mjaft i lumtur që Help ka ndihmuar atë me pajisje të cilat e kanë rritur efikasitetin e punës dhe cilësinë.



BERAT UJKANI

20

Berat Ujkani është themelues i kompanisë Milingona që merret me zhvillimin e web dhe app. Produktet e tij i dedikohen kryesisht tregut ndërkombëtar.

Ai filloi biznesein me dy pajisje të dhuruara nga Help, një laptop Apple dhe një kompjuter portativ. Berati dhe vëllai i tij Vedat u shpërngulën nga Mitrovica e Jugut në Prishtinë për të zhvilluar biznesin e tyre.

Produkti kryesor i tyre janë modele të ndryshme për webfaqe të cilat janë të paraqitura në platformën ndërkombëtare "Themefor-est."

FLORIM GASHI

21

Florim Gashi është fermer nga Prishtina. Ai mori pajisje bujqësore nga Help. Ai ka një serë dhe kultivon domate spinaq, tranguj dhe sallatë të gjelbërta. Florimi gjeneron të ardhura nga kjo fermë gjatë gjithë vitit, sepse ai ka përzier kultura të ndryshme. Tregu i tij kryesor është në Prishtinë.



ZANA QERKEZI

Zana vjen nga një familje e cila ka si traditë rrobaqepësinë dhe dizajnin. Help mbështeti biznesin e saj me pajisje si: hekur profesional për hekurosje, makinë për qepje. Këto pajisje janë duke e ndihmuar shumë Zanën që të kryej porositë e ndryshme më shpejtë dhe me kualitet më të lartë.



BESARTA ALIU

Besarta Aliu është një kliente nga Vushtrria e cila ka hapur një biznes i cili ofron gjëra dekorative si, kuti për dhurata, ora dhe kartolina. Organizata Help e mbështeti Besarten duke i ofruar pajisje si laptop, printer, dhe një sirtar. Në biznesin e saj punojnë dhe familjarët e të afërm.



QENDRESË HOXHA

23

Qëndresë Hoxha është themeluese e restorantit të parë që shërben ushqim të shpejtë të shëndetshëm në Prishtinë të quajtur Green & Protein. Është një vend ku shërbehet ushqim me produkte vendore të papërpunuara, të shëndetshme dhe të freskëta.

Ajo tha: "Të jesh një sipërmarrës është një përpjekje e madhe për të sjellë më shumë vlerë në jetën e njerëzve. Me të vërtetë e vlerësoj dhe jam mirënjohës se çfarë ka bërë "Help Kosovo" për biznesin tim. Pajisjet e kuzhinës që kemi marrë nga ky grant na kanë ndihmuar të jemi më efikas dhe të zhvillojmë më tej biznesin."



SVETISLAV TRAJKOVIĆ

Është fermer nga Gračanica ku dhe posedon rreth 15h tokë. Ai është kultivues i drithërave (elb, grurë, misër). Ai poashtu ka 6 lopë të cilat prodhojnë qumësht të cilin Svetislav e shet në treg. Help e ndihmoi me pajisje të cilat janë të nevojshme për ta kryer punën sa më lehtë, dhe me efikasitet.



SUZANA SUSURI

Suzana është stiliste me pervojë shumëvjeqare, Ajo nga Help përfitoi pajisje për rrobaqepësi ku falë tyre rriti kapacitetin e punës dhe kualitetin dhe punësoi disa punëtorë. Linja e fustanave të saj ka të bëjë kryesisht me motive shqiptare të cilat kanë fituar edhe çmime ndërkombëtare.

ANKICA ĐORIĆ

Ankica është një kliente nga Gračanica e cila është e angazhuar në biznesin e parukeris dhe estetikës. Biznesi gjithashtu ofron shërbime të tjera të tilla si depilim, manikyr, pedikyr etj.

Help mbështeti Ankicen me pajisjet e nevojshme si: makinë për prerjen e flokëve me rregullim dixhital, tharëse flokësh, llambë për thonjë, karrika dhe tavolinë të lëkurës, drejtuese të flokëve, karrike për larjen e flokëve, llambë për tharje të thonjëve, pasqyrë. Të gjitha këto pajisje janë duke e ndihmuar biznesin të vazhdojë përpara dhe në këtë mënyrë Anika po mundet të i plotësoj nevojat e klientëve.



ARD HAXHIDAUTI

Ardi është një dizajner i ri nga Gjakova. Në edicionin e dytë të konkursit të studentëve për dizajn ku u shfaq puna e 40 finalistëve Ardi, klienti ynë fitoi vendin e 2 për dizajnin më të mirë. Help ka mbështetur atë me pajisje teknologjike.



BERAT SADIKU

Berati është një arkitekt i ri nga Vushtrria, ai krijoi biznesin e tij nga e para. Berati dhe kolegu i tij janë të specializuar në dizajnimin e ndërtimeve. Ata nga Help përfituan një printer 3D i cili printon modelet në 3 dimensione si dhe një printer profesional.



QËNDRESË BYTYQI

29

Qëndresa filloi biznesin e saj me donacionin e Help ku mori pajisjet të cilat ishin të mjaftueshme për fillim pasi ajo arriti të zhvilloj biznesin dhe të investojë në dyqanin e saj si dhe të punësojë një punëtorë.

Aktiviteti i saj kryesor është të planifikoj dekorimin e dasmave dhe ditëlindjeve përveç dekoratave ajo shet edhe produkte në dyqanin e saj.

Donacioni nga Help ka ndihmuar Qëndresën të fitojë përvojë të zhvillojë veten si një artiste dhe sipërmarrëse si dhe ja doli të realizojë ëndrrën.



MEJREME BYTYQI

Znj. Bytyqi është pronare e Kopshtit "Foleja". Help i ndihmoi asaj të zgjerojë dhe të kompletoj kopshtin me shtretër, dhe gjëra të tjera elementare. Kjo ndikoi në efikasitetin dhe kualitetin e punës si dhe angazhimin e edukatoreve të tjera.



GENT BERISHA

Genti është arkitekt me profesion dhe pronar i kompanisë së dizajnit InnArc. Ai ka përfutur dy kompjuterë dhe mobilje për zyrë. InnArc është një studio kreative e cila kryen shërbime të ndryshme në fushën e arkitekturës dhe dizajnit.



HYSNIJE GASHI

Hysnije Gashi është pronare e kompanisë "Tradita" që gjendet në Prishtinë, që merret me pjekjen e ushqimit tradicional. Hysnije ka arritur të punësojë të gjithë antarët e familjes së saj si dhe fqinjët. Help e ka mbështetur Hysnijen me grant rreth vlerës 2000 euro (mikser për brumë, stufë profesionale, frigorifer, tavolinë për gatim).

Ky donacion e ka motivuar Hysnijen që të vazhdojë më tutje dhe të rrisë kapacitetin e punës. Pas marrjes së donacionit Hysnije ka punësuar 3 persona me kohe të plotë dhe 3 persona të tjerë me gjysëm orari.

ARTAN MIFTARI

Pronar i biznesit "ART MEDIA". Ky profesionar është gjithqka për mua, është një punë që kërkon perkushtim, talent, vetëbesim". Help ndihmoi Artanin me kamerë profesionale me kualitet të lartë, duke bërë Artanin dhe firmën e tij më profesionale dhe të besueshme për klientët.



KALTRINA VITIJA

Kaltrina është pronare e kompanisë "Kaltrina's cake" që prodhon torte për evente të ndryshme. "Gjithqka filloi si një biznes i vogël, Help më ndihmoi në fillim atëhere kur kisha nevojë për pajisje." Ajo po ashtu shtoi se i inkurajon të gjitha gratë që kanë ide, apo plan biznesi të ndjekin ëndrrën.

NAFIJE AJETI

Nafije Ajeti është themeluese e OJQ "Gratë Femere" nga fshati Sfeçël në Podujevë. Kryesisht këto gra punojnë në kultivimin e perimeve, përpunimin si dhe konservimin e tyre ku më pas ato dalin në treg. Rreth 7 gra janë të punësuar në këtë organizatë.

"Unë jam shumë e lumtur dhe ndihem me fat që jam përfituese e grantit të "Help Kosovo" ky donacion na ka ndihmuar të rrisim efikasitetin dhe kapacitetin e punës" tha Nafije. OJQ "Gratë Femere" është biznes i cili është duke u rritur profesionalisht çdo ditë e më shumë, së fundi këto gra kan qenë pjesë e Panairit Ndërkombëtar Kosovar.



FARUK TEMO

Ai është një klient nga Prizreni, i cili është duke punuar si prodhues i makinerisë për ushqim. Klienti ka filluar të përdor pajisjet e dhuruara nga Help dhe është i kënaqur me cilësinë e tyre. Tregu i tyre janë restorantet, sepse ata ofrojnë shërbime për pajisje të tilla si miksera të mishit, makina dhe grill.



ASLLAN KRASNIQI

Ai prodhon materiale shkrimi për shkolla (fletore, gazeta, pentagramë muzikore etj). Si pjesë e grantit që Asllani ka përfituar është një makinë paketimi për prodhim. Ai është shumë i kënaqur me pajisjet e marra nga Help dhe po vazhdon të punojë dhe të zhvillojë biznesin.



GRATË FERMERE "KRUSHA E VOGËL" 38

Help ka mbështetur shoqatën e grave fermere "Krusha e vogël" me pajisjet e punës të tilla si: ftohës të qumështit, enë për magazinim të qumështit, pompë për zbrazje dhe mbushje. Gratë në këtë shoqatë punojnë me kapacitet maksimal.

Ato kanë kontratë me kompaninë e qumështit "ABI". Me grantin e dhënë nga Help ato ishin në gjendje për të përfshirë 15 fermerë më shumë në shoqatë.

Organizata Help ka ofruar edhe trajnim profesional në fushën e qumështit dhe prodhimin e djathit.



ROLAND KOSHI

Ai është klient i Help nga Prizreni dhe është pronar i një restoranti të vogël. Donacioni nga Help e ka ndihmuar shumë që biznesi të ketë më shumë kapacitet dhe të jetë më stabil. Help ndihmoi Rolandin me pajisje gastronomike për restorantin e tij.



DURIM LAMA

Ai është zdrukthëtar nga Gjakova, nga Help mori pajisje të punës si: Disk Sander, teleskop Sander, prese metalike, sharrë metalike. Puna tashmë është shumë më cilësore dhe më e lehtë se sa më përpara dhe e gjitha kjo falë pajisjeve të marra nga organizata Help u shpreh ai.



ADNAN JAREMHOROZI

41


Adnan Jaremhorozi është klient nga Prizreni i cili ka në pronësi një biznes në fushën e këpucarisë. Kompania e tij prodhon këpucë për meshkuj dhe femra të cilët përpos anës estetike edhe kualiteti i tyre është mjaft i mirë. Ai përdorte makina të vjetra qepëse përpara.

"Unë jam shumë i kënaqur me pajisjet e dhuruara nga Help Kosovo, tani puna është shumë më e lehtë dhe cilësia është shumë më e mirë", tha ai

Të gjithë anëtarët e familjes janë të angazhuar në biznes. Kryesisht klientët janë nga Prizreni dhe vizitorë nga qytetet e tjera të Kosovës dhe turistë që vizitojnë Prizrenin. Ata kanë në plan që të angazhohen më shumë për të punësuar të tjerë në të ardhmen.

ERZA NILA

Erza është nga Peja dhe ka marrë pajisje të bletarisë për aktivitetin e saj. Ajo prodhon ushqim për bletë dhe bën paketimin dhe shitjen e produktit. Donacioni i dhënë nga Help ndihmoi shumë Erzen për të realizuar ëndrrën e saj.



NEXHATI KOVACI

Z. Kovaci është një bletar i cili është i përfshirë në bletari dhe ka më shumë se 150 koshere të bletëve të tipit DB. Produktet e prodhuara nga bletaria përfshijnë: mjaltë, polen dylli, propolis, dhe qumësht blete.

Pajisjet që ka marrë nëpërmjet granteve e kanë mbështetur atë shumë për bletari dhe ai është mjaft i kënaqur me pajisjet e reja, të cilat e kanë lehtësuar punën dhe kanë përmirësuar cilësinë e produkteve. Këshillat e dhëna nga organizata Help ishin kryesisht se si ai duhet të mbrojë kosheren e tij të bletëve nga sëmundjet, të ushqyerit e tyre dhe disa këshilla në trajnimin në fushën e biznesit.

ARTA HAZIRI-NUHIU

Ajo është nga Gjilani, ka aplikuar në Help për ta mbështetur me pajisje për zërim dhe për aktivitete që kanë të bëjnë me muzikë. Ajo tani ka përmirësuar studion e saj dhe ka të gjitha pajisjet e nevojshme për veprimtarinë e saj të quajtur "Mollëkuqet" në Gjilan.



YLL BOSHNIJAKU

Ai vjen nga Peja. Help ka mbështetur aktivitetin e tij me pajisje teknologjike dhe vegla pune. Ai është duke menduar për të zgjeruar biznesin e tij dhe për të punësuar një puntor. Kompania bën instalimin, riparimin dhe mirembajtjen e sistemeve të sigurisë sikur alarma, kamera sigurie, interfona etj.



GENTA ÇARKAXHIJA

Ajo vjen nga Peja, ofron kurse të matematikës për nxënësit e shkollave të mesme. Ajo ka marrë pajisje të teknologjisë së informacionit (kompjuterë) të nevojshme për klasën e saj. Ajo ka në plan për të shtuar shërbime të tjera për të tërhequr më shumë konsumatorë.



VALBONA SEJDIU

47

Valbona vjen nga Prishtina Ajo është nënë e dy fëmijëve. Nga Help Kosovo ajo mori pajisje për pastrim. Emri i kompanisë "Xixë" u emërua nga termi në gjuhën shqipe i përdorur në zhargonin popullor që do të thotë me shëndritë.

Fokusi i kompanisë janë shërbimet e pastrimit kryesisht në banesa shtëpi, zyre. "Ne jemi duke u përpjekur vazhdimisht për të bërë pastrimin sa më ekologjik por me efekte të larta dezinfektues" theksoi Valbona.

Motoja e kompanisë është "Pse të blihen të reja, kur ju mund t'i bëni të reja".



BILJANA DENIĆ

Biljana është një fermere nga Novëbërda. Familja e saj kryesisht punon dhe gjeneron të ardhura nga aktivitetet bujqësore, ku i shesin prodhimet e tyre në tregun e qytetit. Bujqësia është tradita e tyre familjare dhe të gjithë anëtarët e familjes janë të angazhuar në këtë aktivitet.



QENDRA PËR JETË TË PAVARUR – PEJË

Help ka mbështetur organizatën "Qendra për jetë të pavarur", e cila punon për mbrojtjen e të drejtës së personave me aftësi të kufizuara dhe gjithashtu trajnon këtë kategori të shoqërisë për të jetuar në mënyrë të pavarur.

Në këtë Qendër njerëzit me aftësi të kufizuara janë të angazhuar në aktivitete të ndryshme si lexim, si të mësojnë, të këndojnë, vallëzojnë, vizatim, kryesisht aktivitete të jetës së përditshme. Help Kosovo ka mbështetur këtë qendër me pajisje të gastronomisë.

Planet e tyre të ardhshme janë të hapin një mini bar, ku ata mund të shërbejnë prodhimet e tyre, të cilat do të i ndihmojnë ata të gjenerojnë të ardhura për nevojat e tyre.

JEHONA SHALA

Ajo është pronare e një biznesi të vogël në Vushtrr "KS Foods", ku prodhojnë petë të gatshme me paketim të tyre. Produktin kjo kompani e shet në marketet e qyteteve si: Prishtinë, Mitrovicë, Obiliq, Milloshevë, Drenas. Ajo planifikon që kompanisë të saj ti shtojë edhe dy produkte të reja.




SHEND XHEMAJLI

Shendi vjen nga Prishtina. Ai është themeluesi i "Skwer Studio". Ai theksoi se "Help është iniciatori kryesor për suksesin tonë, dhe në qoftë se ne nuk do të kishim këtë mundësi do të ishte shumë e vështirë të realizonim projektin tonë".



NERMIN KASTRATI

Ai është nga Peja i cili prodhon këpucë të punuara me dorë të një cilësie të mirë, si dhe këpucë të veçanta për personat me aftësi të kufizuara. Biznesi i tij ishte në pritje pasi që ai nuk i kishte makinat e duhura. Sot me pajisje të sofistikuara ai mund të bëjë këpucë me cilësi të mirë.



RAMË RADI

Rame Radi jeton në Trebovic fshat në Komunën e Pejës. Klienti punon në fushën e ndërtimtarisë në izolim, fasada dhe suvatimin. Me pajisjet e dhëna klienti është vetë-punësuar dhe ka angazhuar anëtarët e familjes në këtë biznes. Duke e rritur kapacitetin e punës, ai mund të jetë i angazhuar në ndërtime të ndryshme në komunën e Pejës.

Kur punëtorët e Help e vizituan atë, ai jetonte në kushte të vështira në një shtëpi të vjetër të vogël me më shumë se dhjetë anëtarë, ata i takojnë komunitetit rom.

Tani familja gjeneron më shumë të ardhura nga puna që bëjnë dhe pajisjet që ai i ka marrë ndihmuan në lehtësimin e punës dhe rritjen e të ardhurave mujore të familjes.



"Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e fushave të caktuara, me fokus të veçantë zhvillimin ekonomik."

Shqipe Breznica
Kordinatore e Programit

Adresa

Str. Ekrem Rexha, H2. Kati B1, No: 4,
Prishtinë

Email

info@help-kosovo.org

Web:

help-ev.de
help-kosovo.org
facebook.com/helpkosovo

Nr. i telefonit

+383 38 704 302

